



iSIGURT.al
PLATFORMA KOMBËTARE PËR SIGURINË E FËMIJËVE NË INTERNET
ALBANIAN NATIONAL PLATFORM FOR CHILD INTERNET SAFETY

LETËR INFORMUESE PËR RAPORTIN:

TË PËRDHUNUAR NË INTERNET

"INDUSTRIA E INTERNETIT PËRBALLË MBROJTJES SË FËMIJËVE DHE ADOLESHENTËVE NË SHQIPËRI!"

Në bashkëpunim me:



Shqipëria është një vend që ka përqafuar teknologjinë prej vitesh. Ndërsa fëmijët dhe të rinjtë në vend duket se janë ndër përdoruesit kryesorë të internetit, duke përfshirë këtu të gjitha platformat e tij. Por vendi ynë është shumë i ri për sa i përket eksperiencës së mënyrave që duhet të krijohen në mbrojtje të fëmijëve dhe të rinjve si përdorues të internetit.

Viti 2020, i cili u shoqërua edhe me një prej ngjarjeve më të papritura për të gjithë botën, pandeminë Covid-19, solli një tablo të ndryshme nga vitet e tjerë, për sa i përket përdorimit të internetit në Shqipëri. Fillimviti detyroi të gjithë vendin t'i ushtrohet një karantine të detyruar, e cila solli fokusin kryesor të të gjithë fëmijëve, të rinjve por edhe të gjithë të tjerëve drejt të vetmes rrugë të lidhjes asaj të përdorimit të internetit. Teknologjia dixhitale nisi të jetë kryefjala e të gjitha brezave, si edhe të gjitha shtresave shoqërore në vend. Mbyllja e detyruar e fëmijëve dhe të rinjve dhe vendosja e tyre përballë një interneti ende të pasigurt, krijoi përgjatë vitit 2020 edhe një risi për të gjithë ekspertët e sistemit të mbrojtjes së tyre nga grabitqarët seksualë online, atë të rritjes galopante të faqeve pornografike dhe përdorimit pa kriter të platformave gjigande të internetit.


Raporti i 3-të Kombëtar "Të përdhunuar në internet: Industria e Internetit përballë mbrojtjes së fëmijëve dhe adoleshentëve në Shqipëri!", vjen bazuar në një analizë të punës së të gjitha strukturave dhe shërbimeve që çdo ditë punojnë në mbrojtje të fëmijëve nga pasiguria online si Platforma Kombëtare për Internet të Sigurt, shërbimi falas i këshillimit dhe referimit Linja Kombëtare e Telefonit të Ndihmës për Fëmijët ALO 116111, si dhe Qendra Kombëtare për Internet të Sigurt në Shqipëri.

Qëllimi i këtij studimi është, qartësimi i realitetit në të cilin jetojnë, dëfrehen dhe mësojnë fëmijët dhe adoleshentët në Shqipëri, përballë rreziqeve dhe ekspozimit ndaj një vale të dhunshme çdo ditë e në rritje të grabitqarëve seksuale, dhunuesve ndaj fëmijëve në të gjitha format e dhunës online.


Ky raport ka si mision, ndërgjegjësimin e opinionit publik shqiptar për situatën e rrezikshmërisë së internetit dhe sjelljen e rekomandimeve për përmirësimin e të gjitha mekanizmave institucionalë, shtetërorë dhe privat në një bashkërendim dhe mirëfunksionim cilësor me fokus mbrojtjen e fëmijëve nga çdo lloj forme e dhunës në internet. Bazuar në gjetjet dhe rekomandimet e tij, ky raport do të shërbejë edhe si një "zëdhënës" i fëmijëve, familjeve dhe gjithë opinionit publik shqiptar drejtuar institucioneve ligjvënëse të cilat duhet të reagojnë sa më parë në lidhje me rregullimin e kuadrit ligjor në këtë fushë.

Më poshtë po paraqesim disa nga gjetjet dhe rekomandimet kryesore të raportit:

* Gjetja më kritike, në këtë raport është rritja me një shifër shumë të madhe, të 600 fishuar raportimet për pornografi me të mitur. 6273 faqe, foto, video, materiale me përmbajtje të papërshtatshme pornografike janë shfaqur dhe mbyllur brenda harkut kohor të vitit 2020.




* Të rinjtë e grupmoshës mbi 18 vjeç, këtë vit kanë qenë risi përsa i përket numrit të madh të raportimeve krahasuar me një vit më parë. 31% e rasteve kanë qenë mbi moshën 18 vjeç. Kjo gjetje ngre edhe shqetësimin se të rinjtë mbi 18 vjeç që janë “pre” e kërcënimeve, dhunës seksuale dhe shantazhimeve online etj., nuk kanë një platformë që i përket atyre në të cilën ata të raportojnë dhe të mbrohen.



* Pandemia shumëfishoi raportimet e internetit të pasigurt. Muajt Mars, Prill 2020, mbajnë rekordin e tyre.

* Faqet shqiptare kanë shënuar një rritje drastike përsa i përket përdorimit të materialeve të papërshtatshme, të cilat kërcënojnë dhe rrezikojnë fëmijët dhe të rinjtë në përdorimin e internetit. Krahasuar me një vit më parë, ku nga raportimet këto faqe ishin pothuaj zero, këtë vit ato janë rritur në masën 8%.



* Edhe këtë vit, vajzat vijojnë të mbajnë vendin e parë përsa i përket raportimeve për internetin e pasigurt në 54%, krahasuar me djemtë 42%.

* Mosha më e prekur e fëmijëve dhe adoleshentëve nga përdorimi i internetit të pasigurt mbetet mosha 15-17 vjeç, e cila përfshihet në masën 40% të saj.

* Përsa i përket shtrirjes gjeografike të raportimeve të ngacmimeve, dhunës seksuale, pornografisë dhe shfrytëzimit të fëmijëve në internet, qytetet si Durrësi, Korça, Pogradeci, apo edhe Gjirokastra bëjnë pjesë në ato qytete, të cilat duken se nuk raportojnë ende në pjesë të konsiderueshme rastet e problematikave që hasin fëmijët dhe adoleshentët në internet.

* Instagrami vijon të mbetet platforma më e pasigurt për fëmijët shqiptarë

* 40% të rasteve të faqeve pornografike, videove apo edhe imazheve me të njëjtën përmbajtje

gjatë vitit 2020 i përkasin fëmijëve shqiptarë, ndërsa mbi 60% e rasteve të pornografisë me të mitur i përkasin fëmijëve jo shqiptarë, por të aksesueshëm nga fëmijët dhe adoleshentët në vend.

* 70% e rasteve që kanë raportuar dhunë apo denigrim të imazhit janë djemtë.

* 69% e rasteve të nuditetit i përket vajzave dhe 66% e rasteve të ngacmimeve seksuale i përket sërish gjinisë së vajzave.

* Një gjetje tjetër që duhet nënvizuar është se vajzat kanë qenë në masën më të madhe të tyre të përndjekura, të kërcënuara dhe të shantazuara nëpërmjet internetit. 68% e vajzave kanë raportuar këtë fenomen.

* Loja e rrezikshme vdekjeprurëse që kërcënoi fëmijët dhe adoleshentët gjatë vitit 2020 "Jonathan Galindo", zuri masën 3% të raportimeve.

* Sektori i Krimeve Kibernetike pranë Policisë së Shtetit është një prej institucioneve të cilët në punën e tyre kanë patur ende mangësi përsa i përket ndjekjes së rasteve të referuara prej ISIGURT.al dhe ALO 116 111.

* Viti 2020 shënoi një vit suksesi. 64% e rasteve janë totalisht të mbyllura, një shifër kjo që bazuar në numrin e rasteve që kanë ndodhur gjatë këtij viti dhe vijueshmërinë dhe intensitetin që kanë patur paraqitet shumë e lartë krahasuar me vitet e tjera.

Platforma Kombëtare (Hotline) www.ISIGURT.al ka marrë përgjatë vitit 2020 rreth 17.000 vizita në webin e saj, gjë kjo që reflekton mundësinë e madhe që paraqet ajo për të denoncuar incidentet e internetit të pasigurtë nga fëmijët, të rinjtë, prindërit dhe të interesuarit.

REKOMANDIMET KRYESORE

Mbështetur në risitë pozitive apo edhe negative që solli analizimi i të gjitha detajeve të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve dhe adoleshentëve në Shqipëri, rendisim disa rekomandime kryesore drejtuar këto institucioneve ligj-vënëse dhe ligj-zbatuese në Shqipëri, organizatave që punojnë për fëmijët, si dhe opinionit publik.

1. Kuvendi i Shqipërisë të nisë hartimin e domosdoshëm të një **ligji specifik mbi mbrojtjen e fëmijëve në internet, kërkesë kjo e CRCA/ECPAT Shqipëri prej disa vitesh.**
2. **Të gjitha nenet, të cilat i adresohen gjuhës së urrejtjes në legjislacionin aktual,** kanë nevojë të domosdoshme të adresohen për shumë kategori të cilat nuk janë përfshirë në to, me fokus gjininë e tyre dhe më gjerë.
3. **Përfshirja në shqyrtimin dhe miratimin parlamentar të procedurës së ndryshimeve dhe shtesave në Kodin Penal, propozime këto nga CRCA/ECPAT Shqipëri etj.**
4. **Forcim dhe rishikim të punës së sektorit të Krimit Kibernetik pranë Policisë së Shtetit** përsa i përket mundësimin të ndjekjes dhe finalizimit të rasteve të referuara nga organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet që punojnë për fëmijët e të rinjtë në Shqipëri.
5. **Krijimi i një strukture/platformë kombëtare, e cila do të bëjë të mundur raportimin e rasteve për të gjithë të rinjtë mbi moshën 18 vjeç në Shqipëri,** të cilët ndihen të rrezikuar dhe kërcënuar nga përdorimi i internetit.

6. **Ndërmarrja urgjente e fushatave ndërgjegjësuere mbi sigurinë online të fëmijëve** dhe gjetja e qasjeve tërësisht të reja nga ana e institucioneve publike për mbrojtjen e fëmijëve ndaj përmbajtjes dhe sjelljeve të rrezikshme në internet.
7. Ministria e Arsimit përpos fushatave, manualeve **duhet të organizojë në mënyrë periodike aktivitete me fokus fëmijët dhe mësuesit** për të diskutuar mbi masat që mund të merren së bashku për lundrimin e fëmijëve dhe të rinjve sa më të sigurt në internet.
8. Pas përfundimit të Planit të Veprimit 2018-2020 “Mbi internetin e sigurt për fëmijët në Shqipëri”, Axhendës Dixhitale 2015-2020 dhe Axhendën Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017-2020, **duhet të rishikohet vijueshmëria e tyre për të hartuar dokumenta të reja** që do të ndihmonin fëmijët dhe adoleshentët në një lundrim sa më të sigurt në internet.
9. **Përfshirja e organizatave, fëmijëve, të rinjve etj., në edukim bashkëmohatar për të krijuar kështu fuqizim të tyre dhe përdorim me përgjgjësi të internetit.**
10. Institucionet përgjegjëse për fëmijët si MASR dhe MSHMS **të mundësojnë promovimin e platformave kombëtare si psh Platforma Kombëtare www.ISIGURT.al** dhe modulën e saj RAPORTO, duke krijuar një ndërgjegjësim edhe institucional për fëmijët dhe të rinjtë.
11. Bazuar në gjetjen e këtij raporti në të cilën faqet shqiptare shënojnë në përqindjen e tyre një pasiguri të madhe për fëmijët dhe adoleshentët **rekomandohet që AKEP së bashku me organizatat e të drejtave të fëmijëve duhet të nisë një dialog sa më të gjerë dhe pozitiv ndërmjet portaleve, organizatave të mediave dhe institucioneve arsimore**, për të vendosur një sistem rregullues më të fuqishëm në mënyrë që asnjë portal të mos shkelë të drejtat e fëmijëve.
12. Të gjitha platformat e informimit të publikut shqiptar dhe argëtimit në gjuhën shqipe, pra ato platforma adresa e të cilave përfundon me .AL, duhet të veprojnë në përputhje dhe në respekt me Ligjin për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve në Shqipëri. Bazuar në lirinë e fjalës, shprehjes dhe të drejtës së informimit që i përket edhe fëmijëve, **çdo organizatë e medias elektronike në internet duhet të nënshkruajë Kodin e Etikës dhe ti përmbahet standarteve të kujdesit për fëmijët.**
13. Të gjitha organizatat e shoqërisë civile të cilat punojnë çdo ditë me fëmijët dhe të rinjtë duhet t'i kushtojnë një hapësirë të veçantë jo vetëm informimit të fëmijëve në lidhje me pasigurinë në internet, **por edhe luftës së tyre për ndryshimin e Kodit Penal që i mbron ata nga dhuna dhe shfrytëzimi online.**

CRCA/ECPAT SHQIPËRI

Tel: +355675002025

E-mail: crca@crca.al